Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

GBWN
GENDER BUDGET WATCHDOG NETWORK

International Partnerships Austria

Sverige

BUXHETI I QYTETARËVE 2026
PERSPEKTIVA GJINORE

Analizë e Buxhetit të Shqipërisë nga Perspektiva Gjinore

KONCEPTET KRYESORE

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR

E trajton buxhetin si një instrument për transformimin e marrëdhënieve shoqërore dhe jo thjesht si një proces teknik të shpërndarjes së burimeve financiare. Kjo qasje zbatohet në reformimin e menaxhimit të financave publike, përmes buxhetimit sipas programeve, planifikimit buxhetor afatmesëm dhe buxhetimit të bazuar në performancë.

NDIKIMI NGA PERSPEKTIVA GJINORE

Tregon se si buxhetet publike, kur marrin parasysh nevojat dhe rrethanat e ndryshme të grave dhe burrave, mund të kontribuojnë në rritjen e punësimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimin e mirëqenies, uljen e varfërisë dhe pabarazive, si dhe në një zhvillim ekonomik më gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm..

BUXHETI NGA PERSPEKTIVA E QYTETARËVE

Paraqet buxhetin zyrtar në një mënyrë të thjeshtuar, të kuptueshme dhe vizualisht tërheqëse, duke evidentuar se si shpenzimet publike ndikojnë ndryshe te gratë dhe burrat, si dhe cilat programe dhe politika qeveritare synojnë promovimin e barazisë gjinore dhe zvogëlimin e hendekut gjinor.

PABARAZIA GJINORE

I referohet pabarazive në mundësi, në aksesin ndaj burimeve, në të drejta dhe në rezultate mes grave dhe burrave. Të dhënat e besueshme të ndara sipas gjinisë ndihmojnë në identifikimin e këtyre pabarazive dhe në vlerësimin nëse politikat dhe shpenzimet publike po kontribuojnë realisht në zvogëlimin e tyre.

KUADRI LIGJOR BAZË PËR BUXHETIMIN E PËRGJIGJSHËM GJINOR

01 LIGJI PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

02 LIGJI PËR BARAZINË GJINORE

03 LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

04 LIGJI PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË FAMILJE

05 LIGJI PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

06 UDHËZIMET VJETORE PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM (PBA)


07 STRATEGJIA KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE

08 KODI I PUNËS

09 LIGJI PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

10 LIGJI PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

FONDET BUXHETORE PËR PROGRAMET E PËRGJIGJSHME GJINORE SIPAS SEKTORËVE




87 nga 131 programet buxhetore të Shqipërisë përfshijnë elemente të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028.

Në vitin 2026, 824,5 milionë euro janë alokuar për programe që përfshijnë Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor, duke dëshmuar integrimin e kësaj qasjeje në fusha të rëndësishme të shpenzimeve publike.

Nga sektorët e paraqitur, mbrojtja sociale dhe arsimi zënë peshën më të madhe të fondeve të alokuara për programe të përgjigjshme gjinore, përkatësisht me 326 milionë euro dhe 305,5 milionë euro.

FONDET BUXHETORE PËR PROGRAMET E PËRGJIGJSHME GJINORE SIPAS SEKTORËVE, 2026



Fondet më të mëdha për programet e përgjigjshme gjinore janë përqendruar në:


- **Mbrojtjen sociale**
- **Arsimin**
- **Shëndetësinë**
- **Rendin dhe drejtësinë**
- **Mbështetjen e sipërmarrjeve**

Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor është integruar në të paktën një program buxhetor në 11 ministri të linjës dhe 31 institucione të qeverisjes qendrore, duke dëshmuar shtrirjen e kësaj qasjeje në planifikimin buxhetor afatmesëm të Shqipërisë.

MBROJTJA SOCIALE

Programet e mbrojtjes sociale luajnë një rol të rëndësishëm në avancimin e barazisë gjinore, duke ofruar mbështetje financiare dhe shërbime të dedikuara për gratë në faza të ndryshme të jetës, si dhe për gratë në kushte vështirësie ekonomike. Masat e përgjigjshme gjinore përfshijnë ndihmën ekonomike, pagesat për personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre, mbështetjen për gratë e papuna me tre ose më shumë fëmijë, përfitimet e lejes së lindjes, strehimin social dhe shërbimet e kujdesit rezidencial. Këto programe kontribuojnë në uljen e varfërisë dhe përjashtimit social, si dhe në forcimin e sigurisë sociale dhe ekonomike të grave.





SEKTORI I ARSIMIT

Arsimi është një nga sektorët kryesorë të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor. Masat e përgjigjshme gjinore janë integruar në të gjitha nivelet e arsimit, duke mbështetur aksesin e barabartë në mundësitë për arsimim dhe duke nxitur pjesëmarrjen e vajzave dhe grave.

Megjithëse vajzat dhe gratë kanë një nivel të lartë pjesëmarrjeje në shumicën e niveleve të arsimit, pabarazi të konsiderueshme gjinore vijojnë të jenë të pranishme në arsimin profesional.





SEKTORI I SHËNDETËSISË

Programet shëndetësore të përgjigjshme gjinore fokusohen te shëndeti parandalues, riprodhues dhe amësor i grave, duke mbështetur diagnostikimin e hershëm, trajtimin dhe aksesin në shërbimet thelbësore shëndetësore.

Masat kryesore përfshijnë depistimin për kancerin e gjirit dhe të qafës së mitrës, kujdesin për nënat, rindërtimin e gjirit, paketat e fertilizimit in vitro (IVF) dhe kontrollet parandaluese shëndetësore.






MBËSHTETJA E SIPËRMARRJES

Programet e mbështetjes së sipërmarrjes kontribuojnë në fuqizimin ekonomik të grave, duke rritur aksesin në financim, mbështetur bizneset e drejtuara nga gratë dhe nxitur pjesëmarrjen e tyre në inovacion, sipërmarrje dhe turizëm.

Instrumentet e reja të përgjigjshme gjinore, të prezantuara për vitin 2026, forcojnë integrimin e barazisë gjinore në politikat e zhvillimit ekonomik.





ÇFARË NDRYSHOI NË BUXHETIN E VITIT 2026?

MINISTRIA E FINANCAVE
2026
BUXHETI I SHTETIT

1. PESHA E BUXHETIMIT TË PËRGJIGJSHËM GJINOR NË BUXHET

9,5%
e shpenzimeve totale publike janë alokuar për politika të përgjigjshme gjinore në vitin 2026.

Rreth 85
programe buxhetore

Rritje nga 9,1%
në vitin 2025

2. FUSHA TË REJA TË BUXHETIMIT TË PËRGJIGJSHËM GJINOR NË VITIN 2026

- INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA
- ZHVILLIMI I TURIZMIT

Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor zgjerohet në fusha të reja të politikave ekonomike në vitin 2026.

3. PUNËSIMI DHE PAGAT

50.000 LEKË
NË MUAJ
Paga minimale në vitin 2026.

Pritet të përfitojnë veçanërisht gratë e punësuara në sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale.



SI MUND TË RRITET PJESËMARRJA E QYTETARËVE?

Shqipëria e ka integruar gjithnjë e më shumë Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor në kuadrin e saj të planifikimit buxhetor afatmesëm. Megjithatë, pjesëmarrja e qytetarëve mbetet e kufizuar nga mungesa e të dhënave të mjaftueshme të ndara sipas gjinisë, raportimi i pamjaftueshëm mbi përfituesit dhe rezultatet konkrete, si dhe mekanizmat e dobët të monitorimit. Përmirësimi i aksesit në informacionin buxhetor, rritja e transparencës në raportim dhe krijimi i mundësive për përfshirjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile mund të forcojnë llogaridhënien publike dhe pjesëmarrjen kuptimplotë në menaxhimin e financave publike nga perspektiva gjinore.

STATISTIKAT DHE TË DHËNAT GJINORE

Të dhënat e ndara sipas gjinisë duhet të mblidhen, analizohen dhe publikohen në mënyrë sistematike për të gjitha programet buxhetore. Informacioni i besueshëm mbi gratë dhe burrat që përfitojnë nga programet publike është thelbësor për të kuptuar se kush përfiton realisht nga shpenzimet publike dhe nëse masat e përgjigjshme gjinore po arrijnë grupet e synuara. Përdorimi i treguesve gjinorë më të qartë dhe rezultateve të matshme do të mundësonte një vlerësim më të saktë, të bazuar në evidenca, të progresit në zvogëlimin e hendekut gjinor dhe pabarazive.





TRANSPARENCA DIGJITALE DHE LLOGARIDHËNIA

Informacioni buxhetor i aksesueshëm dhe transparent duhet të krijojë një lidhje të qartë mes objektivave gjinorë dhe fondeve të planifikuara, shpenzimeve faktike, përfituesve dhe rezultateve të arritura. Publikimi i këtij informacioni në formate të kuptueshme dhe të aksesueshme do t'u mundësonte qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të ndjekin zbatimin e programeve të përgjigjshme gjinore, të vlerësojnë nëse fondet e alokuara po japin rezultatet e pritshme dhe të forcojnë llogaridhënien publike për angazhimet në fushën e barazisë gjinore.

PJESËMARRJA E VAZHDUESHME E QYTETARËVE

Qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të kenë mundësi më të shumta dhe të vazhdueshme për t'u përfshirë në të gjitha fazat e ciklit buxhetor, nga konsultimi dhe përcaktimi i prioriteteve deri te monitorimi i zbatimit dhe vlerësimi i rezultateve. Aksesi në informacion buxhetor të qartë dhe në të dhëna të ndara sipas gjinisë do të mundësonte pjesëmarrje kuptimplotë, duke ndihmuar qytetarët të vlerësojnë nëse burimet publike u përgjigjen nevojave të ndryshme dhe të advokojnë për një shpërndarje më të drejtë dhe më efikase të fondeve publike.

